

VENDIMET E BORDIT TË DATËS 17 SHTATOR 2020

Në mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të Federatës të mbajtur më 17 shtator 2020, me shumicë votash të anëtarëve u morën këto vendime:

Vendimi Nr. 2020-29

Ceremonia e Laureatëve 2020

- Bazuar në nenin 11 të rregullores #06 për organizimin e ceremonisë për shpalljen e më të mirëve të vitit, bordi me shumicë votash merr vendim që për vitin 2020 të mos ketë Ceremoni të Laureatëve për shkak të ndikimit të pandemisë "Covid- 19.
- Më të mirët do të shpallën pa ceremoni.

Vendimi Nr. 2020-30

Angazhimi i një individit në administrimin e ueb faqes së FTK-së

- Pas tërheqjes së z. Fisnik Bullatovci i cili ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e ueb faqes së FTK-së dhe në përputhje me pikën 14.1 të statutit të FTK-së, bordi me shumicë votash merr vendim që administrata e FTK-së të kërkojë një individ tjetër i cili do të angazhohet në menaxhimin dhe rregullimin e ueb faqes.
- Ky individ të merret me dizajn të faqes, bartje të shënimeve dhe mirëmbajtje në përgjithësi.

Vendimi Nr. 2020-31

Përkrahja financiare e referëve në Fed/Davis Cup;

- Në përputhje me nenin 11. të rregullores #03 për përkrahjen e referëve, miratohet me shumicë votash propozimi që referat e angazhuar si ndihmës referë në garat Fed/Davis Cup të përkrahen financiarisht nga FTK me një vlerë fikse prej 75 euro për pjesëmarrje.
- Vendimi do të reflektohet në Rregulloren përkatëse.

Vendimi Nr. 2020-32

Ndryshimet në mëditjet e referëve

- Miratohet me shumicë votash propozimi për ndryshimin e mëditjeve për referët mbikëqyrës të cilët angazhohen njëkohësisht edhe në referim në karrige.
- Referi i cili është edhe mbikëqyrës dhe referë karrige do të kompensohen si në vijim:

- 40€ për mbikëqyrje dhe 10 euro shtesë për çdo referim në karrige.
- Ndryshimi vlen vetëm nëse i njëjti është edhe refer mbikëqyrës edhe refer karrige.
- Ndryshimi të reflektohet në Rregulloren përkatëse.

Vendimi Nr. 2020-33

Rregullat e reja të Rankingut

- Bordi me shumicë votash merr vendim që vendimi 2020/27 i datës 22.06.2020 për sistemin e ri të rankingut gjatë periudhës “Covid – 19” të mbetet i tillë për aq sa kanë vlefshmëri.

Vendimi Nr. 2020-34

Kërkesë drejtuar Kuvendit Komunal rreth fushave në Prishtinë

- Bordi me shumicë votash merr vendim që administrata e FTK të i drejtohet përmes një shkrese zyrtare Kuvendit Komunal në Prishtinë në lidhje me shfrytëzimin e fushave publike të tenisit në Prishtinë.

Vendimi Nr. 2020-35

Menaxhimi i fushave në Ferizaj

- Bordi me shumicë votash miraton propozimin që duhet angazhuar dikë për menaxhimin e fushave të reja në Komunën e Ferizajt, ndërkohë që do të kontaktohen fillimisht trajner Edon Ademi dhe Festim Ibrahimimi për të shikuar mundësinë e bashkëpunimit, nëse të njëjtit nuk janë të gatshëm do të kontaktohet të tjerët.

Vendimi Nr. 2020-36

Komisioni Disiplinor për trajtimin e ankesave

- Bordi me shumicë votash dhe në përputhje me pikën 6.6. të statutit të FTK-së, emëron komisionin disiplinor për trajtimin e ankesave të pranuar.
- Në komision emërohen:
 1. Sevem Gjinaj – Kryesuese e Komisionit
 2. Ylber Shamlli – Anëtar i Komisionit
 3. Vërshim Hatipi – Anëtar i Komisionit



Vendimi Nr. 2020-37

Kursi “ASMC 3” organizuar nga KOK

- Miratohet me shumicë votash propozimi që për pjesëmarrje në kursin “ASMC 3” që organizohet nga KOK të ftohen të gjithë kandidatët që janë certifikuar në Kursin Bazik për Administrim Sportiv.
- Kandidati që i përgjigjet së pari ftesës do të propozohet në KOK për pjesëmarrje në “ASMC 3”.